

L I G J
Nr. 8689, datë 16.11.2000

PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT HIV/AIDS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Infeksioni HIV/AIDS (ose SIDA) është sëmundja e shkaktuar nga virusi i mangësisë së fituar të imunitetit njerëzor dhe në këtë kuptim “Personat e infektuar nga HIV-i, janë persona të infektuar nga virusi i imunodeficitit njerëzor”.

Neni 2

Ky ligj është i detyrueshëm për të gjithë personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, të cilët ndodhen ose janë të regjistruar dhe zhvillojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Garancitë për të drejtat dhe liritë e personave të infektuar nga HIV-i, si dhe detyrimet e parashikuara në këtë ligj janë të vlefshme edhe për shtetasit e huaj që banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Komisioni Kombëtar i luftës kundër HIV/AIDS-it, që funksionon pranë Ministrisë së Shëndetësisë, ka atributet e një Komisioni Kombëtar Ndërmnistror. Në përbërje të këtij komisioni janë zëvendësministrat e këtyre dikastereve:

Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Kulturës, Rinisë e Sporteve, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministrisë së Financave, si dhe përfaqësues nga RTSH-ja.

Komisioni Kombëtar Ndërmnistror i HIV/AIDS-it i propozon Këshillit të Ministrave për marrjen e vendimeve përkatëse për parandalimin dhe luftimin e kësaj sëmundjeje.

Këshilli i Ministrave vendos për detyrat dhe funksionet e këtij Komisioni.

Neni 5

Ministria e Shëndetësisë përcakton, me akte nënligjore, strukturën dhe funksionet e shërbimit shëndetësor për:

- a) diagnozën konfirmuese laboratorike të HIV-it pranë qendrave kombëtare të referencës;
- b) trajtimin e të sëmurëve në kushte spitalore pranë shërbimeve kombëtare dhe rajonale, sipas standardeve të OBSH-së;
- c) trajtimin, këshillimin dhe mbështetjen psikologjike të të sëmurëve ose bartësve të HIV-it në kushte ambulatorie, pranë dispancerive rajonale të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (SST), si

dhe kujdesin në shtëpi;

ç) mbikëqyrjen sero-epidemiologjike të përhapjes së infeksionit HIV në territorin e Republikës së Shqipërisë;

d) regjistrimin, deklarimin dhe raportimin e të sëmurëve me AIDS.

KREU II ROLI I INSTITUCIONEVE SHETËRORE

Neni 6

Shteti siguron informim të rregullt për popullsinë, duke përdorur të gjitha format dhe mjetet legale të komunikimit masiv për masat parandaluese të infeksionit HIV.

Neni 7

Ministria e Shëndetësisë përcakton, me akte nënligjore, mënyrat e parandalimit, të diagnostikimit dhe të trajtimit të infeksionit nga HIV-i, si dhe të kontrollit për HIV-in të lëngjeve biologjike dhe të indeve që përdoren me qëllim diagnostik, terapeutik ose shkencor.

Neni 8

Institucionet shëndetësore shtetërore realizojnë ekzaminimin laboratorik falas për zbulimin e infeksionit HIV, me qëllim:

- a) diagnostikimin e të sëmurëve të dyshimtë (me emër);
- b) studimin sero-epidemiologjik dhe shkencor (anonim i palidhur);
- c) kërkim vullnetar (me emër);
- ç) kërkim vullnetar (pa emër, me kod);

Tarifat e pagesës vendosen nga Ministria e Shëndetësisë në rastet e ekzaminimit me kërkesë për plotësim dokumentesh shëndetësore.

Neni 9

Çdo person që i nënshtrohet ekzaminimit laboratorik për infeksionin HIV, gëzon të drejtën e kontrollit paraprak në një qendër mjekësore, si dhe të ruajtjes së konfidencialitetit dhe të sekretit mjekësor. Nxjerrja e sekretit mjekësor nga cilido person juridik në fjalë, pa dëshirën e personit të infektuar, dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 10

Shteti mbështet financiarisht zhvillimin e kërkimeve shkencore për problemet që lidhen me infeksionin HIV, përfshirjen në programet pedagogjike të institucioneve arsimore të aspekteve të edukimit moral dhe seksual, zhvillimin e programeve të promocionit dhe të edukimit shëndetësor për formimin e arsimitarëve, të edukatorëve dhe të personelit shëndetësor.

KREU III PARIME TË NDIHMËS MJEKËSORE

Neni 11

Shteti siguron çdo lloj kujdesi shëndetësor, barnat për mjekimin ambulator ose në spital, si dhe transportin falas të përcaktuar për nevojat e kujdesit mjekësor për qytetarët shqiptarë të sëmurë me HIV/AIDS.

Neni 12

Ekzaminimi mjekësor, specifik për infeksionin HIV, realizohet vetëm në institucionet e sistemit shëndetësor shtetëror të vendit të autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 13

Ekzaminimi mjekësor për HIV-in kryhet vullnetarisht, me përjashtim të rasteve:

- a) të parashikuara në ligjin nr.7761, datë 19.10.1993 “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse”, si dhe të ligjit nr.8032, datë 16.11.1996 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut, të produkteve të tij dhe transplantimeve”;
- b) të pacientëve të shtruar në institucionet shëndetësore për qëllime diagnostikimi.

Neni 14

Çdo person, që i nënshtrohet një ekzaminimi mjekësor për HIV-in, gëzon të drejtën që përfaqësuesi i tij legal të jetë i pranishëm gjatë ekzaminimit. Në rastet kur bëhet fjalë për një fëmijë nën 14 vjeç ose kur personi ligjërisht është i paaftë, ekzaminimi mjekësor mund të kryhet me kërkesën dhe pëlqimin e përfaqësuesve legalë të tyre, të cilët kanë të drejtë të jenë të pranishëm edhe gjatë ekzaminimit mjekësor.

Neni 15

Asnjë dokument i ekzaminimit mjekësor për HIV-in nuk është i detyrueshëm për qytetarët e huaj që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga koha e qëndrimit të tyre.

Neni 16

Çdo person, që i është nënshtuar një ekzaminimi mjekësor për HIV-in, ka të drejtë të kryejë një ekzaminim tjetër që mund të realizohet në të njëjtin laborator ose në një laborator tjetër të autorizuar, sipas dëshirës së tij, pavarësisht nga koha kur e ka kryer ekzaminimin e parë.

KREU IV

E DREJTA E INFORMIMIT TË PERSONIT TË INFEKTUAR ME HIV

Neni 17

Çdo person tek i cili është zbuluar një infeksion nga HIV-i, duhet të vihet në dijeni për rezultatin nga mjeku i ngarkuar pranë dispancerisë së specializuar spitalore, ambulatorie ose klinikës ku është kryer këshillimi dhe ekzaminimi mjekësor. Sipas pëlqimit të personit të infektuar, ky rezultat i komunikohet personave të tjerë që ai dëshiron.

Neni 18

Personeli i laboratorit, që kryen ekzaminimin, nuk ka të drejtë t’i tregojë rezultatin pozitiv të infektuarit me HIV ose të afërmve të tij.

Neni 19

Në rast të zbulimit të infeksionit HIV te personat nën 18 vjeç, si dhe te personat me pazotësi juridike, rezultati i ekzaminimit mjekësor u komunikohet të afërmve ose përfaqësuesve ligjorë të të infektuarit.

KREU V

MBËSHTETJA SOCIALE PËR PERSONAT E INFEKTUAR ME HIV

Neni 20

Personat me moshë deri 18 vjeç, të cilët janë infektuar nga HIV-i, kanë të drejtë të përfitojnë një pension ose ndihmë sociale, kur ata janë të paafët për të punuar.

Neni 21

Janë të ndaluara: pushimi nga puna, mospranimi në punë, mospranimi në një institucion arsimor, shëndetësor, kufizimet e të drejtave të tjera dhe të interesave të ligjshëm, si ajo e banimit dhe në fusha të tjera të jetës, si për personat e infektuar nga HIV-i dhe për anëtarët e familjeve të tyre, duke nxjerrë si shkak infeksionin me HIV/AIDS.

Neni 22

Prindërit, fëmijët e të cilëve janë të infektuar nga HIV-i ose përfaqësuesit legalë të tyre kanë të drejtë:

a) T'u shërbejnë fëmijëve deri në moshën 18 vjeç, në një institucion spitalor, duke zbatuar detyrimet dhe rregullat e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

b) Njëri nga prindërit ose përfaqësuesi legal i një fëmije të infektuar nga HIV-i, me moshë deri 18 vjeç, përfiton udhëtim falas në rast shoqërimi për marrjen e ndihmës mjekësore, deri në institucionin shëndetësor dhe për kthim.

c) Njëri nga prindërit ose përfaqësuesi legal i fëmijës së infektuar nga HIV-i, me moshë deri 18 vjeç, i ruhet vjetërsia në punë për kohën që ai i shërben fëmijës së sëmurë. Kjo periudhë përcaktohet nga institucioni shëndetësor dhe vërtetohet me raport mjekësor.

ç) Prindërit ose përfaqësuesit legalë, që kanë në ngarkim një fëmijë me HIV, me moshë deri në 18 vjeç, kur ai banon me ta, duhet të përfitojnë, në mënyrë parësore nga fondet shtetërore të ndërtimeve, për të përmirësuar kushtet e banimit, kur ato gjykojnë të domosdoshme.

Mënyra dhe masa e përfitimeve sipas shkronjave “b”, “c” dhe “ç” rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VI DISPOZITA KALIMTARE

Neni 23

Institucionet shëndetësore publike ose private dëmshpërblejnë personin e infektuar me HIV sipas legjislacionit në fuqi, në rastet kur infektimi është kryer si pasojë e mosrespektimit të rregullave gjatë ushtrimit të detyrës nga personeli mjekësor.

Neni 24

Çdo marrëveshje ndërkombëtare, ku vendi ynë është palë e që përcakton rregulla të tjera të paparashikuara në këtë ligj, merr përparësi.

Neni 25

Ministria e Shëndetësisë përcakton rregullat e mbrojtjes në punë nga infeksioni HIV, si dhe stimulon me pagë punonjësit që merren me diagnozën laboratorike të HIV-it dhe me kujdesin e drejtpërdrejtë të të sëmurëve me AIDS.

Neni 26

Shmangia e personelit mjekësor ndaj diagnozës, kontrollit dhe mjekimit të të sëmurëve me HIV-AIDS, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në

vlerën e dy pagave mujore. Kjo masë merret me vendim të titullarit të institucionit përkatës.

Procedurat për vënien e gjobës dhe ankimin rregullohen nga ligji nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 27

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e neneve 4,7,10,22 dhe 25 të këtij ligji.

Neni 28

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2814, datë 5.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani